



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Nr. 1026 Prot.

Tiranë, më 28 2021

Lënda : Kërkesë për publikim “Shpallje për Nënpunës Civil,Lëvizje Paralele dhe për Ngritjen në Detyrë”

Drejtuar: **SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT**

TIRANË

Enti Rregullator i Energjisë, ka vendosur të shpallë procedurën e konkurimit Lëvizje Paralele dhe për Ngritjen në Detyrë për dy pozicionet :

- 1.“Drejtore në Drejtorinë e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve ,Kategoria e pages II-b”
2. “Drejtore në Drejtorinë e Mbrojtjes së Konsumatorit ,Performancës dhe Standarteve Kategoria e pages II-b”

Për këtë arsye, në përputhje me Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në bazë e në zbatim të tij, kërkojmë publikimin e pozicioneve në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Bashkëlidhur do të gjeni kërkesën përkatëse për publikim.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

PETRIT AHMETI

Konceptoi:G.Goxhara

Miratoi:Elton B. Radheshi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE

NGRITJE NË DETYRË

PRANIM NGA SHËRBIMIT CIVIL

NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE

DREJTOR I MONITORIMIT TË TREGUT DHE INSPEKTIMEVE

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut V-“Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015,“ Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” si dhe vendimin 142, date 12.03.2014., Per pershkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e administratës shtetërore dhe Institucionet e pavarura“ si dhe planit vjetor të pranimit 2021 në Entin Rregullator të Energjisë, Njësia Përgjegjëse e ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, pranim nga shërbim civil në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues për pozicionin:

**DREJTOR DREJTORIE NË DREJTORINË E MONITORIMIT TË TREGUT DHE
INSPEKTIMEVE**

Kategoria e pagës II-b.

Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit nga shërbimi civil. Numri i pozicioneve për të cilat do të konkurohet është 1(një).

Afati për dorëzimin e dokumenteve :

25.10.2021 deri ne 03.11.2021

Lëvizja paralele

01.12.2021 deri ne 15.12.2021

Ngritje në detyrë

Misioni i Drejtorit Drejtori i Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi, monitoron, kontrollon dhe inspekton funksionimin e tregut të energjisë elektrike në mënyrë që të sigurohet nxitja e konkurrencës efektive, transparenca dhe siguria e funksionimit të tregut të energjisë elektrike, përfshirë dhe shërbimet e balancimit si dhe monitoron zbatimin e rregullave të blerjes së energjisë elektrike; zbatimin e planit të investimeve; zbatimin e Kodeve të rrjetit dhe matjes së energjisë elektrike si dhe sigurinë kibernetike “cyber security” për operatorët. Përgatit praktika për marrjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme nga pjesëmarrësit e tregut dhe të liçencuarit në sektorin e energjisë elektrike për përpilimin e raporteve përkatëse.

Qëllimi i pozicionit të punës: Monitoron zbatimin e detyrimit të transparencës prej të liçencuarve; Ndjek zbatimin e Rregullave të Tregut, dhe Kodeve të operatorëve të sistemit të Energjisë Elektrike; Bashkëpunon me drejtoritë e tjera në hartimin dhe rishikimin e kuadrit nënligjor; Monitoron Operatorin e Tregut për identifikimin e problemeve dhe pengesave për hapjen dhe zhvillimin e Tregut të Energjisë. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Liçencimit, monitoron ndarjen e aktiviteteve të operatorëve sipas përcaktimeve të ligjit për sektorin e energjisë elektrike. Monitoron zbatimin e “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike

Përshkrimi përgjithësues i punës

1. Monitoron zbatimin e detyrimit të transparencës prej të liçencuarve;
2. Ndjek zbatimin e Rregullave të Tregut, dhe Kodeve të operatorëve të sistemit të Energjisë Elektrike;
3. Bashkëpunon me drejtoritë e tjera në hartimin dhe rishikimin e kuadrit nënligjor;
4. Drejton aktivitetin e ERE për monitorimin dhe inspektimin e aktivitetit të Pjesëmarrësve të Tregut;
5. Përgatit raporte vlerësimi për zhvillimin e tregut të Energjisë Elektrike, përfshirë procedurat e blerjes së energjisë elektrike, programeve të investimeve dhe marrëveshjeve të pjesëmarrjes në tregun e energjisë elektrike.
6. Monitoron Operatorin e Tregut për identifikimin e problemeve dhe pengesave për hapjen dhe zhvillimin e Tregut të Energjisë.
7. Monitoron Operatorin e Tregut mbi zbatimin e legjislacionit që lidhet me Tregun Energjisë Elektrike.
8. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Liçencimit, monitoron ndarjen e aktiviteteve të operatorëve sipas përcaktimeve të ligjit për sektorin e energjisë elektrike.
9. Grumbullon të dhënat dhe informacionet e nevojshme nga pjesëmarrësit e tregut dhe të liçencuarit sektorin e energjisë elektrike për përpilimin e raporteve, me qëllim informimin e Bordit si dhe përmbushjen e detyrimit për publikim periodik sipas legjislacionit në fuqi.
10. Në përputhje me gjetjet e monitorimeve, përgatit informacion për Bordin, përfshirë rekomandime përkatëse kur konstaton problematike.
11. Propozon ndryshimin ose amendimin e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera që lidhen me tregun e energjisë elektrike.

12. Merr pjese në grupet e punës të ngritura me Urdhër të Kryetarit në pëprthje me kompetencat rregullatore të ERE.
13. Monitoron zbatimin e “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”.
14. Mban kontakte me institucione dhe struktura homologe me qëllim shkëmbimin e eksperiencës në pëprthje me detyrat që mbulon drejtoria.

1-LEVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nënpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJE PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë për levizjen paralele si vijon:

- të jetë nënpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon kategoria II-b
- të mos ketë masa disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit pozitiv “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diploma të nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor” në fushën e Inxhinierisë Elektrike.
- Të kenë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në profesion dhe preferohet 3 vite pune në fushën Energjitike.
- Të ketë marrë pjesë në trajnime në nivel kombëtar/ ndërkombëtar në fushën e energjistikës.
- Të ketë dëshmi të mbrojtjes së gjuhës angleze (dokumenti i gjuhës së huaj mund të jetë një çertifikatë/diploma, apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur;

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Fotokopje të diplomës të arsimimit e noterizuar;
- Vërtetime të institucioneve që dëshmojnë eksperiencë pune në nivelin e profesionit si dhe librezë pune.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, në nivel kombëtar e në nivelin ndërkombëtar, apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Aktin e emërimit si nënpunës civil, për nivelin përkatës të konkurimit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo pranë zyrës së Protokollit në institucion, brenda datës 03.11.2021 (10 ditë kalendarike nga data e shpalljes) 2021.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda datës **05.11.2021**, njësia përgjegjëse e ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse e ngarkuar e institucionit ku ndodhet pozicioni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët të paraqiten në Njësinë Përgjegjëse të ngarkuar, brenda 3 (tre) ditëve pune nga shpallja e listës. Njësia përgjegjëse e ngarkuar pranë ERE-s, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

A. Njohuritë mbi:

1. Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
2. Ligjin Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” I ndryshur.

3. Ligjin Nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
4. Ligjin Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", i ndryshuar;
5. Ligjin Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit";
6. Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";
7. Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike";
8. "Kodi i Rrjetit të Transmetimit" i miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, date 10.11.2017 I ndryshur me vendimin e Bordit nr. 129, date 04.06.2018.
9. "Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes", miratuar me Vendimi e Bordit të ERE-s me Nr.100, date 26.08.2008
10. "Kodi i Matjes" miratuar me Vendimi e Bordit të ERE-s, Nr.101, date 26.08.2008
11. "Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike" miratuar me VKM Nr. 519, datë 13.7.2016
12. Rregullat e Tregtimit dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
13. "Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike".
14. Rregullat për publikimin e të dhënave të tregut të energjisë elektrike
15. "Rregullore e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar"
16. Rregulloren e Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit i ngritur në ERE, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës të strukturuar me gojë .Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) Vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve që përfshin vlerësimin e arsimit, eksperiencës dhe trajnimeve në fushën përkatëse, si dhe vlerësimet e menaxhimit të nivelit të lartë drejtues në organizma rajonale ndërkombëtare - 40 pikë.
- b) Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
 - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - Eksperiencën e tyre të mëparshme
 - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë për karrierën

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimin për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, ERE do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- NGRITJE NË DETYRË / PRANIMI NGA SHËRBIMI CIVIL

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe/ose pranim nga shërbimi civil.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e ERE-s, **pas datës 01.12.2021.**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin vakantë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE/OSE NGA SHËRBIMI CIVIL KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë II-b;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

- Të zotërojnë diploma të nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor” në fushën e Inxhinierise Elektrike.
- Të kenë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në profesion dhe preferohet 3 vite pune në fushen Energjitike.
- Të ketë marrë pjesë në trajnime në nivel kombëtar/ ndërkombëtar në fushën e energjistikës.
- Të ketë dëshmi të mbrojtjes së gjuhës angleze (dokumenti i gjuhës së huaj mund të jetë një certifikatë/diploma, apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë .
- Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;
- Të gëzojë integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1) jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>.
- 2) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 3) fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 4) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 5) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 6) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 7) letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 8) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 9) një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- 10) aktin e emërimit si nëpunës civil (për aplikantët për ngritje në detyrë)

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 15.12.2021, në Entin Rregullator të Energjisë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimin nga shërbimi civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ERE-s pas datës 15.12.2021.

Njësia përgjegjëse e ngarkuar e ERE-s, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.Ere.gov.al listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

2.2 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

1. Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
2. Ligjin Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” I ndryshur.
3. Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dale në zbatim të tij;
4. Ligjin Nr. 8480, date 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i ndryshuar;
5. Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”;
6. Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
7. Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
8. “Kodi i Rrjetit të Transmetimit” i miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, date 10.11.2017 I ndryshur me vendimin e Bordit nr. 129, date 04.06.2018.
9. “Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes”, miratuar me Vendimi e Bordit të ERE-s me Nr.100, date 26.08.2008
10. “Kodi i Matjes” miratuar me Vendimi e Bordit të ERE-s, Nr.101, date 26.08.2008
11. “Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike” miratuar me VKM Nr. 519, datë 13.7.2016
12. Rregullat e Tregimit dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
13. “Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”.
14. Rregullat për publikimin e të dhënave të tregut të energjisë elektrike
15. “Rregullore e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar”
16. Rregulloren e Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.

2.3 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit në ERE, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- vlerësimin me shkrim, deri në dyzetë pikë (40)
- b- intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në dyzetë pikë (40);
- c- jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në njëzetë pikë (20).

2.4 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.ere.gov.al . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës personale së e-mail-it te kandidatit)*.

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia përgjegjëse e Ngarkuar njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që Komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimit për rezultatin e pikëve brenda 3 (tre) ditëve kalendrike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.ere.gov.al . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë dhe/ose pranim nga jashtë shërbimit civil, në këtë procedurë, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të kesaj procedure;

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Ere-s duke filluar nga data 15.12.2021 e në vijim.

Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE

NGRITJE NË DETYRË

PRANIM NGA SHËRBIMI CIVIL

NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT DREJTUESE

**DREJTOR I MBROJTJES SE KONSUMATORIT PERFORMANCES DHE
STANDARTEVE**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut V-“Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015,“ Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” si dhe vendimin 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e administratës shtetërore dhe Institucionet e pavarura“ si dhe planit vjetor të pranimin 2021 në Entin Rregullator të Energjisë, Njësia Përgjegjëse e ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë, pranim nga shërbim civil në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues për pozicionin:

**DREJTOR I MBROJTJES SË KONSUMATORIT PERFORMANCËS DHE
STANDARTEVE**

Kategoria e pagës II-b.

Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimin nga shërbimi civil.

Numri i pozicioneve për të cilat do të konkurohet është 1(një)

Afati për dorëzimin e dokumenteve:

25.10.2021 deri në 03.11.2021

Lëvizja paralele

01.12.2021 deri ne 15.12.2021

Ngritje në detyrë

Misioni i Drejtorit Drejtori i mbrojtjes së konsumatorit, performancës dhe standarteve trajton dhe zgjidh të gjitha ankesat dhe konfliktet direkte që lindin nga marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike apo gazit natyror dhe klienteve, si dhe midis të Liçencuarve, në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Qëllimi i pozicionit të punës: Trajton dhe zgjidh të gjitha ankesat dhe konfliktet direkte që lindin nga marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike apo gazit natyror dhe klienteve, si dhe midis të Liçencuarve, duke pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të klienteve në aspektin individual dhe mbrojtjen e interesave të tyre në tërësi nga abuzimet e aktorëve dominant në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Përshkrimi përgjithësues i punës

1. Trajton dhe zgjidh të gjitha ankesat dhe konfliktet direkte që lindin nga marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike apo gazit natyror dhe klienteve, si dhe midis të Liçencuarve, duke pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të klienteve në aspektin individual dhe mbrojtjen e interesave të tyre në tërësi nga abuzimet e aktorëve dominant në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

2. Në bashkëpunim me Drejtorinë e tjera, ushtron kontrolle në Operatorin e Transmetimit, Operatorin e Shpërndarjes, Furnizuesin e Shërbimit Universal dhe Furnizues të tjerë për zbatimin e kushteve të Kontratës së Furnizimit me energji elektrike dhe Rregullores së Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Rregullave të cilësisë së shërbimit në aktivitetin e transmetimit.

3. Përgatit rekomandime dhe asiston në hartimin e akteve ligjore dhe legjislacionin sekondar të ERE-s lidhur me çështjet e mbrojtjes së klienteve.

4. Kryen sondazhe për të ekzaminuar dobishmërinë e shërbimeve të kompanisë kundrejt furnizuesit dhe kryesisht lidhur me vazhdimësinë e furnizimit, treguesit të standarteve të garantuara dhe cilësisë së furnizimit, aktivitetit të furnizuesit për transparencën ndaj klientëve.

5. Informon klientet për të drejtat dhe detyrimet e tyre si dhe për mundësinë që ata kanë për të kërkuar informacionin e nevojshëm dhe rrugën e zgjidhjes së problemeve.

6. Përgatit dhe organizon seancat dëgjimore si dhe siguron transparencën dhe kujdeset për pjesëmarrjen e publikut dhe të grupeve të interesit në këtë proces.

7. Kujdeset dhe bashkëpunon me Shoqatat e Konsumatorëve dhe të përfaqësuesve kryesorë të përdoruesve dhe mban kontaktë të vazhdueshme me ta.

8. Informon Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive teknike çdo muaj mbi ankesat e paraqitura në ERE dhe trajtimin e tyre.

9. Përgatit raportime periodike në përputhje me përcaktimet e “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të ERE-s”.

1-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nënpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJE PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët për lëvizjen paralele duhet të plotësojnë kriteret si vijon :

-të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon kategoria II-b

- të mos ketë masa disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);

-të ketë të paktën vlerësimin e fundit pozitiv “mirë”apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diploma të nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor” në fushën e Drejtësisë;
- Të kenë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në profesion dhe preferohet 3 vite pune në fushën Energjitikës.
- Të ketë marrë pjesë në trajnime në nivel kombëtar/ ndërkombëtar në fushën e energjitikës.
- Të ketë dëshmi të mbrojtjes së gjuhës angleze (dokumenti i gjuhës së huaj mund të jetë një certifikatë/diploma, apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;
- Të gëzojë integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Fotokopje të diplomës të arsimimit e noterizuar;
- Vërtetime të institucioneve që dëshmojnë eksperiencë pune në nivelin e profesionit si dhe librezë pune.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, në nivel kombëtar e në nivelin ndërkombëtar, apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Aktin e emërimit si nëpunës civil, për nivelin përkatës të konkurimit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo pranë zyrës së Protokollit në institucion, brenda datës 03.11.2021 (10 ditë kalendarike nga data e shpalljes)2021.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda dates **05.11.2021**, njësia përgjegjëse e ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia përgjegjëse e ngarkuar e institucionit ku ndodhet pozicioni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët të paraqiten në Njësinë Përgjegjëse të ngarkuar, brenda 3 (tre) ditëve pune nga shpallja e listës. Njësia përgjegjëse e ngarkuar pranë ERE-s, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

A. Njohuritë mbi:

1. Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
2. Ligjin Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”
3. Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
4. Ligjin Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i ndryshuar;
5. Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”;
6. Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
7. Ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
8. Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
9. Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
10. Ligjin Nr. Nr. 9902, datë 17.4.20081 “Për mbrojtjen e konsumatorit” i ndryshuar, aktet nënligjore të dala në zbatim;
11. Direktiva e BE- lidhur me mbrojtjen e konsumatoreve.
12. Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
13. Rregulloren e Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit i ngritur në ERE, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës të strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) Vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve në fushën përkatëse, si dhe vlerësimet e menaxhimit të nivelit të lartë drejtues në organizma rajonale ndërkombëtare - 40 pikë.
- b) Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:
 - Njohuritë, aftësitë, kopetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - Ekspericën e tyre të mëparshme
 - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë për karrierën

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, "*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*", të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatit e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimit për rezultatit e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatit. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatit, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, ERE do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë institucionit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- NGRITJE NË DETYRË / PRANIMI NGA SHËRBIMI CIVIL

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe/ose pranim nga shërbimi civil.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e ERE-s, pas datës 01.12.2021.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin vakantë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE/OSE NGA SHËRBIMI CIVIL KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë II-b;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

- Të zotërojnë diploma të nivelit “Bachelor” dhe “Master Shkencor” në fushën e Drejtësisë.
- Të kenë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në profesion dhe preferohet 3 vite pune në fushën Energjitike.
- Të ketë marrë pjesë në trajnime në nivel kombëtar/ ndërkombëtar në fushën e energjistikës.
- Të ketë dëshmi të mbrojtjes së gjuhës angleze (dokumenti i gjuhës së huaj mund të jetë një certifikatë/diploma, apo dëshmi e lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së;
- Të gëzojnë integritet të lartë moral, figurë të pastër etiko-morale dhe është i shquar për përgatitje të lartë profesionale;

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1) jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>.
- 2) fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

- 3) fotokopje të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 4) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 5) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 6) vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 7) letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 8) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- 9) një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- 10) aktin e emërimit si nëpunës civil (për aplikantët për ngritje në detyrë)

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 15.12.2021, në Entin Rregullator të Energjisë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimin nga shërbimi civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ERE-s pas datës 15.12.2021.

Njësia përgjegjëse e ngarkuar e ERE-s, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.ere.gov.al listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit. Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

2.2 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

1. Ligjin Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
2. Ligjin Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” I
3. Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij;
4. Ligjin Nr. 8480, date 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i ndryshuar;
5. Ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”;

6. Ligjin Nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
7. Ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
8. Ligjin Nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
9. Ligjin Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
10. Ligjin Nr. Nr. 9902, datë 17.4.20081 “Për mbrojtjen e konsumatorit” i ndryshuar, aktet nënligjore të dala në zbatim;
11. Direktiva e BE-së lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve.
12. Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
13. Rregulloren e Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.

2.3 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit në ERE, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimi me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- vlerësimin me shkrim, deri në dyzetë pikë (40)
- b- intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në dyzetë pikë (40);
- c- jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në njëzetë pikë (20).

2.4 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.ere.gov.al . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës personale të e-mail-it të kandidatit*).

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia përgjegjëse e Ngarkuar njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që Komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimit për rezultatin e pikëve brenda 3 (tre) ditëve kalendrike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga data përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar e Entit Rregullator të Energjisë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare www.ere.gov.al . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë dhe/ose praninë nga jashtë shërbimit civil, në këtë procedurë, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të kësaj procedure;

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;

-për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ERE-s duke filluar nga data 15.12.2021 e në vijim.

Njësia Përgjegjëse e Ngarkuar